

Vendim nr. 34 datë 12.02.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Illir Toska,	Anëtar

në datën 12.02.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 22 (F) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **FATIME DEHARAJ (LIMANI)**, përfaqësuar nga avokatët Pjetër Ndreca dhe Agim Çela, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Plotësimi dhe interpretimi i vendimit nr. 223, datë 08.10.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Fatime Deharaj është motra e të ndjerit Xh.L. Ata dhe shtetasja H.S. janë fëmijë të të njëjtëve prindër. Nga ana tjetër, nëna e tyre L.L., nga një martesë tjetër, ka pasur edhe pesë fëmijë. Përgjatë periudhës së viteve 1951-1980, vëllai i kërkuësës, shtetasi Xh.L., është dënuar në 3 raste me heqje lirie, punë të detyruar dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet, për veprat penale të dezertimit, pjesëmarrjes në një organizatë kundër pushtetit popullor me qëllim arratisje dhe agjitacionit e propogandës të parashikuara nga legjislacioni i kohës. Ai ka ndërruar jetë i ve në datën 26.04.1985, ndërsa vuante dënimin. Në vitin 1995, me vendim të

Komisionit Shtetëror Trepalësh, këtij shtetasi i është dhënë statusi i ish të përndjekurit politik, bazuar në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” (ligji nr. 7748/1993).

2. Në datën 12.11.2007 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 9831 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” (ligji nr. 9831/2007), me objekt, ndër të tjera, përcaktimin e përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist, nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta, si burgim ose masa mjekësore të detyrueshme, si pasojë e një apo disa vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, gjykatave speciale apo të urdhrave të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991 (neni 1). Sipas këtij ligji, në rastin kur i dënuari nuk jeton më dëmshpërblimi për të burgosurit politikë u takon në pjesë të barabarta familjarëve të tij (neni 6), sipas përcaktimeve të ligjit. Në zbatim të ligjit, Këshilli i Ministrave në vijim ka miratuar vendimin nr. 382, datë 19.05.2010 “Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist” (VKM nr. 382/2010), ku përfshihej edhe dëmshpërblimi për shtetasin Xh.L., në vlerën 13 656 137 lekë. Për familjarët përfitues të këtij dëmshpërblimi, sikundër dhe për sa i përket procesit të shpërndarjes së tij, mes kërkueses e motrës së saj, nga njëra anë dhe motrave dhe vëllait nga nëna, nga ana tjetër, kanë lindur mosmarrëveshje, të cilat janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

3. Në datën 06.08.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vendimet nr. 1014 (86-2023-1357), datë 07.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-1448, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe 6 akte të Ministrisë së Financave, që lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar për sa i përket mosmarrëveshjes për shpërndarjen e dëmshpërblimit financiar, sipas ligjit nr. 9831/2007. Po kështu, në kërkesën drejtuar Gjykatës ajo ka kërkuar edhe shfuqizimin e togfjalëshit “pa praninë e palëve” në paragrafin 6 të nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke e zëvendësuar me togfjalëshin “me praninë e palëve, kryesisht të avokatëve të tyre”.

4. Me vendimin nr. 223, datë 08.10.2024 (vendim nr. 223/2024), Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Kolegji ka vlerësuar, ndër të tjera, se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, si rrjedhojë e mosnjoftimit për datën e seancës nga Gjykata Administrative e Apelit dhe e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë pa praninë e palëve, ishin të pabazuara, pasi gjykimi i çështjes në këto

gjykata ishte vënë në lëvizje nga kërkuesja përmes ankimit dhe rekursit dhe gjykatat kishin mbajtur qëndrim për pretendimet e saj. Në lidhje me kërkesën për shfuqizimin e togfjalëshit në dispozitën e KPC-së, Kolegji, duke pasur parasysh edhe jurisprudencën kushtetuese në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe juridiksionin e Gjykatës në rastet e përplasjes së ligjeve me njëri-tjetrin, ka vlerësuar se kërkuesja nuk kishte paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të tyre. Po kështu, Kolegji ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkueses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si rrjedhojë e kontradiksionit, sipas saj, në qëndrimin e gjyqtarit relator të gjykatës së apelit që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për themelin e çështjes, me vendimin e këtij gjyqtari për pranimin e rekursit të saj, sikundër po ashtu edhe midis këtij të fundit dhe vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të saj. Në lidhje me këto pretendime, Kolegji ka vënë në dukje se vendimet në fjalë janë të natyrave të ndryshme dhe nuk ka kontradiktë mes tyre. Kolegji ka sqaruar, gjithashtu, se fjala “seleksionim” e përdorur në arsytimin e vendimit të Gjykatës së Lartë ishte pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese, ndërsa pretendimet e kërkueses për veprimtarinë e këshilltarit ligjor nuk i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues.

5. Në lidhje me pretendimet e tjera, të analizuara në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private, në përfundim të shqyrtimit të tyre, Kolegji ka arritur në konkluzionin se ato për parimin e sigurisë juridike kishin të bënin, në thelb, me proceset gjyqësore civile të vëna në lëvizje nga kërkuesja dhe subjektet e tjera, për sa i takon përcaktimit nga gjykatat e zakonshme të rrethit të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Xh.L. Ndonëse këto vendime ishin bërë objekt analize dhe vlerësimi nga Ministria e Financave dhe gjykatat e zakonshme gjatë procesit gjyqësor administrativ të vënë në lëvizje nga kërkuesja, për detyrimin e ministrisë për të kaluar në llogarinë e saj pjesën e mbetur të dëmshpërblimit, objekt i vlerësimit konkret të Kolegjit ishin vendimet gjyqësore që kishin vendosur për procesin administrativ. Në lidhje me to, Kolegji ka çmuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, brenda funksioneve të tyre ligjore dhe kushtetuese për zbatimin e interpretimin e legjislacionit në fuqi, kishin dhënë përgjigje të arsytuar në lidhje me mosveprimet e institucionit shtetëror për pagesën e dëmshpërblimit. Ministria e Financave kishte vepruar sipas ligjit dhe ishte kërkuesja e cila duhej të vinte në dispozicion të këtij institucioni aktet që përcaktonin në mënyrë përfundimtare rrethin e trashëgimtarëve të të ndjerit. Po sipas Kolegjit, gjykatat i kishin dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe përfundimi i arritur prej tyre nuk binte ndesh me kuptimin e parimit të “gjësë së gjykuar”.

6. Në datën 12.12.2024 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar plotësimin dhe interpretimin e vendimit nr. 223/2024 të Kolegjit të Gjykatës.

II

Pretendimet e kërkeses

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në vendimin e kundërshtuar të Kolegjit të Gjykatës, në Kreun III “Vlerësimi i Kolegjit”, nuk përmenden:

- përmbajtja e plotë e akteve zyrtare me fuqi provuese të zyrës së gjendjes civile Ostren, Bulqizë, të lëshuara në vitet 1993, 1994, 2012 dhe 2019, si dhe e vendimit nr. 6775, datë 22.12.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që pasqyrojnë trungun familjar të të ndjerit Xh.L. me përbërje prej 5 anëtarësh, konkretisht prindërit, vëllai, kërkesja dhe motra H.S.;
- përmbajtja e plotë e dëshmisë noteriale të trashëgimisë nr. 107, datë 01.11.1994, ku si trashëgimtare ligjore të trashëgimlënësit Xh.L. janë përcaktuar dy motrat e tij, kërkesja dhe H.S.;
- fakti i pagesës në vitin 1994 të dëmshpërblimit prej 2 213 427 lekësh në letra me vlerë, sipas ligjit nr. 7748/1993, dhe i pagesës në vitin 2012 të këstit të parë të dëmshpërblimit prej 1 000 000 lekësh, sipas ligjit nr. 9831/2007, të kryera nga Ministria e Financave në favor të kërkeses dhe motrës H.S., pagesa këto që mbeten të ligjshme dhe për të cilat ato gëzojnë siguri juridike, çka, e lidhur me parimin e ligjshmërisë, paanësisë dhe drejtësisë, bën që kërkesa e saj të jetë e mbështetur në prova dhe ligj dhe duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare;
- përmbajtja e plotë e vendimit nr. 2337, datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka lëshuar saktë dëshminë e trashëgimisë për të ndjerin, duke përcaktuar kërkesen dhe motrën H.S. si trashëgimtare të tij, në bazë të së cilës ato kanë përfituar këstin e parë të dëmshpërblimit dhe duhet të përfitonin edhe këstet e radhës, çka do të thotë se kërkesa e saj është e mbështetur në prova dhe ligj dhe duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare;
- përmbajtja e vendimeve nr. 243, datë 20.06.1995 të Gjykatës së Rrethit Bulqizë; nr. 627, datë 04.12.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe nr. 850, datë 11.04.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilat janë të falsifikuara në pjesën urdhëruese dhe nuk janë dëshmi trashëgimie të vëllait të ndjerë Xh.L, çka për të

cilën kërkesa e saj është e mbështetur në prova dhe ligj dhe duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare;

- fakti se djali i shtetasës Z.N., e cila nuk është ligjërishtr motra e të ndjerit Xh.L., i ka dorëzuar privatisht juristes së Ministrisë së Financave vendimet gjyqësore të falsifikuara, të cilat janë pranuar prej saj në shkelje të hapur të nenit 60 të Kodit të Procedurës Administrative, duke konsumuar disa vepra penale, me qëllim ndërprerjen arbitrare të pagesës së dëmshpërblimit;
- fakti se 6 shkresat e Ministrisë së Financave, që mbështeten në vendimet gjyqësore të falsifikuara, kanë në përmbajtje të dhëna të rreme apo të falsifikuara, të nxjerra nëpërmjet mashtrimit, që në vazhdimësi kanë dëmtuar interesat legjitimë të kërkuases, dokumente të cilat Kolegji duhet t'ia dërgonte prokurorisë për hetim;
- fakti se vendimet nr. 6139, datë 13.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. 1014, datë 07.12.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-1448, datë 08.04.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë të falsifikuar, pasi mbështeten kryesisht në vendimin e falsifikuar nr. 243, datë 20.06.1995 të Gjykatës së Rrethit Bulqizë, dokumente të cilat Kolegji duhet t'ia dërgonte prokurorisë për hetim;
- fakti se Gjykata Administrative e Apelit, në shkelje të rëndë të neneve 128-131, 141 dhe 143-144 të KPC-së, nuk e ka njoftuar për zhvillimin e seancës gjyqësore as kërkuesen në adresën e banimit, as avokatin e saj në adresën e zyrës dhe atë elektronike, duke i cenuar të drejtën për t'u dëgjuar, ndaj ky vendim duhej shfuqizuar dhe çështja të dërgohej për rigjykim në atë gjykatë;
- fakti se Ministria e Financave ka marrë pjesë në gjykim jo për të mbrojtur interesat legjitimë të saj, por për të favorizuar interesat ilegjitimë të personave ilegjitimë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuases

8. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës parashikon se pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj. Ndërkohë, neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet shqyrtimit paraprak nga Kolegji i Gjykatës, i cili vlerëson nëse ankimi përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji për kalimin e çështjes në seancë plenare. Ky ligj dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*) kanë parashikuar më tej rregullat e detajuara të

procedurave të gjykimit kushtetues, duke parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Në kuptim të këtyre parashikimeve, një prej rasteve në të cilin mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet saktësimi dhe plotësimi i vendimit me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (neni 80 i ligjit nr. 8577/2000). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqet për gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në to.

9. Në rastin në shqyrtim, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për plotësimin dhe interpretimin e vendimit nr. 223/2024 të Kolegjit të saj, duke pretenduar se në seksionin ku pasqyrohet vlerësimi i Kolegjit nuk përmenden ose nuk përmenden plotësisht disa fakte, të cilat më tej nuk janë interpretuar drejt nga Kolegji. Po ashtu, kërkuësja pretendon se Kolegji duhej të kalonte çështjen për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë në kundërshtim me Kushtetutën.

10. Në lidhje me pretendimin e kërkuëses se faktet e pasqyruara në vendim nuk janë pasqyruar ose janë pasqyruar në mënyrë të paplotë, ky Kolegj vë në dukje se faktet e rëndësishme për çështjen gjejnë pasqyrim në një seksion tjetër të vendimit nr. 223/2024 të Kolegjit (paragrafët 1 - 11). Nga ana tjetër, Kolegji vëren se, ndryshe nga sa kërkuësja ka parashtruar, nuk rezulton që faktet e pasqyruara në vendimin nr. 223/2024 të mos jenë në përputhje me aktet shkresore të depozituara nga ajo bashkë me ankimin kushtetues individual fillestar të datës 06.08.2024. Kolegji thekson se pasqyrimi në vendim i fakteve në përgjithësi është i ndryshëm nga interpretimi i fakteve me natyrë kushtetuese në kuadër të vlerësimit të pretendimeve në ankimin kushtetues individual, ndaj pretendimi i kërkuëses, në fakt, duket se ka të bëjë me thelbin e vendimmarrjes së mëparshme të Kolegjit të Gjykatës.

11. Për sa i përket pretendimit të kërkuëses se pretendimet e saj në ankimin kushtetues individual janë të mbështetura, ndaj çështja duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare, është e qartë se ka të bëjë me thelbin e vendimmarrjes së mëparshme të Kolegjit.

12. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkesa e paraqitur për plotësimin dhe interpretimin e vendimit nr. 223/2024 të Kolegjit, në thelb, ka të bëjë me mënyrën e vlerësimit të pretendimeve të parashtruara nga kërkuësja në ankimin e saj kushtetues individual të datës 06.08.2024, pra nuk ka të bëjë me ndonjë prej rasteve të parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores, domethënë për gabime në shkrim, në llogari ose pasaktësi të vendimit.

13. Për rrjedhojë, në rrethanat kur pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me mënyrën se si Kolegji ka vlerësuar ankimin e saj kushtetues individual (fillestar), për sa kohë vendimet e Gjykatës nuk mund të bëhen objekt kontrolli ose rishikimi as nga vetë ajo, përveç rasteve të përcaktuara në mënyrë të shprehur në nenet 71/c dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, dhe në kushtet kur kërkuësja nuk ka argumentuar dhe provuar se ndodhet para ndonjërit prej këtyre rasteve, Kolegji vlerëson se ajo nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me një kërkesë të tillë.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.